



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e parë e K.K-së, e cila do të mbahet më **14.12.2021** (e Marte) duke filluar në ora **11:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inaguruese K.K-së Novobërdë;
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;
3. Caktimi i zavendëskryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;
4. Zgjedhja e nënkryetarit për Komunitete të Komunës së Novobërdës;
5. Formimi i Komitetit për Politik dhe Financa;
6. Formimi i Komitetit për Komunitete;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 07.12.2021
Në: Novobërdë

Stojan Stanojevic
Antari më i vjetër





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nr/Br 01/1191
LidhData 03.12.2021

Nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 30.11.2021 duke filluar nga ora 11:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës i sapozgjedhur Sasa Milosevic, Kryetari i deritanishëm Svetislav Ivanovic, anëtarët e Kuvendit të sapozgjedhur, përfaqësues nga MAPL, përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni, përfaqësuesit e KFOR-it, mediat, qytetarët dhe zyrtarët e Komunës së Novobërdës.

Mbledhjen e udhëheqi anëtari më i vjetër Stojan Stanojevic pasi përshëndeti të pranshmit tha: jam i nderuar që sot kryesoj Seancen Inauguruese të Kuvendit, duke dëshiruar që kjo seancë të jetë shembull pozitiv se si do të qeverisimi bashkarishtë për të mirën e qytetarëve, anëtarëve të rinjë ju uroi punë të suksesshme gjatë këtyre katër viteve, si dhe përfaqësim të qytetarëve të Komunës pa dallim nacionaliteti.

Pasë kësaj z.Stanojevic e konstatoi kuorimin ku i thirri me emër anëtarët e rinjë.

- 1.Ivana Ivanovic
- 2.Stefan Kovacevic
- 3.Stojan Stanojevic
- 4.Ramush Mehmeti
- 5.Violeta Milosevic
- 6.Selatin Nuhiu
- 7.Xhevat Mehmeti
- 8.Vlora Vllasaliu
- 9.Negovan Jovanovic
- 10.Ivica Cenic
- 11.Mirjana Simijonovic
- 12.Abdyl Gashi
- 13.Dragana Dimic
- 14.Milica Jovanovic
- 15.Dobrivoje Djordjevic

Sipas konstatimit prezent janë të gjithë antarët dhe ka kuroum për ta filluar mbledhjen inauguruese.

Stojan Stanojevic e hapi mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Novobërdës me këtë:

Rend dite

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;
3. Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Pika e parë: Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës neni 5 pika 5

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e dhanë betimit, që do t'i kryejnë me nder, besnikri pa anime e me ndërgjegjëje dhe sipas ligjit detyrat ku do t'i ushtrojnë autorizimet e tyre si anëtar të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Pasë betimit të anëtarëve të Kuvendit Stojan Stanojevic e ftoi Kryetarin e sapozgjedhur që ta japë betimin.

Pika e dytë: Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës.

Kryetari i sapozgjedhur Sasa Milosevic pasi përshëndeti të pranishmit tha: falenderoj kryesuesin për dhënien e fjalës, i urojë antarët e Kuvendit për mandatin katër vjeçare dhe unë si Kryetar i komunës sikur se edhe të tjerët dua të jap betimin (të betohem) para këshilltarve para qytetarëve që kanë dhënë votën dhe në emër të Ligjit dua të jap betimin.

Në bazë të nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale për nder të zgjedhjes si Kryetar i Komunës duhet të jap betimin para këshilltarve të Kuvendit të komunës.

Unë Sasa Milosevic betohem se do t'i kryej detyrat dhe obligimet si Kryetar i Komunës së Novobërdës me nder besnikëri pa anime në mënyrë që të siguroj kushte për jetë të qetë për të gjithë qytetarët.

Pika e tretë: Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës Sasa Milosevic pasi dha betimin tha: fillimishtë ju uroj mirëseardhje të gjithë të pranishmeve, përfaqësuesve të përkatësive fetare, përfaqësuesve të KFOR-it, të OSBE-së, të ministrës dhe të tjerëve të pranishëm. Novobërda është shtëpi për të gjithë ne, pamvarsishtë se Novobërda është shtëpia e të gjithë ne e të gjitha Komuniteteve dhe përkatësive të ndryshme, shpresojmë se për këto katër vitet e ardhshme do ta ngrisim në një nivel më të lartë këtë bashkpunim dhe këtë bashkjetesë. Ne gjithmonë duhet të fillojmë nga vet vetja andaj ju them se për periudhen e ardhshme atë që sja dua vetit nuk ja dua askujt, nuk do doja që dikush të punoj më shumë apo më pak se unë, deshiroj që të jem shembull për të gjitha komunitetet, shqiptarë, serb, romë dhe komunitete tjera që jetojnë, kështu që ta dini se dyert e mija dhe dyert e kësaj Komune janë të hapura për të gjithë qytetarët e Komunës, ju faleminderit.

E gjithë puna për këto vite është kryer nga të tjerët andaj e ftoj Kryetarin e Komunes së mëhershëm të Novobërdës që të na drejtohet me disa fjalë.


Svetislav Ivanovic pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha: pas zgjedhjeve që kanë qenë në nivelin më të lartë demokratik mendoj se është sukses për të gjithë ne. Ju falenderohem të gjithëve dhe ju uroj punë të suksesshme, fat si dhe Kryetarit të ardhshëm i uroj suksese në punë. Këto suksese nuk kishim pasur mundësi që ti arrijmë pa ndihmen e donatorëve të ndryshëm. Deshmi se kemi bashkjetesë kemi përkrahje është se janë prezent zonjat nga MAPL, përfaqësuesit e KFOR-it, të UNMIK-ut, përfaqësuesit e Komuniteteve fetare, kjo deshmon që jemi Komunë ku bashketojmë.

Urime edhe njëher dhe faleminderit.

Mbledhja inaguruese përfundoi në orën 11:30.

Valmire Mustafa

Procesëmbajtëse



Stojan Stajonevic

Anëtar i më i vjetër i Kuvendit

